

A hand in a dark suit sleeve with a light-colored shirt cuff is holding a solid orange rectangular card. The card is positioned vertically and is the central focus of the lower half of the image. The background is a light grey wall with a large, stylized orange shape that resembles a speech bubble or a large letter 'S' on the left side.

# Udhëzues për zgjedhjet



Centar za građansko obrazovanje  
Centre for Civic Education

**Botuesi:**

Qendra për Arsimim Qytetar (QAQ)



*Centar za gradansko obrazovanje*  
*Centre for Civic Education*

**Autori:**

dr Nikolla Mugosha

**Dizajni dhe produksioni:**

Qendra për Arsimim Qytetar (QAQ)

**Përkthimi në gjuhën shqipe:**

Monika Mrnjaçeviq

**Qarkullim:**

50

ISBN 978-9940-44-048-0

COBISS.CG-ID 24048900

Përbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorit.

# Udhëzues për zgjedhjet

Podgoricë, 2022.

# Përmbajtja

Hyrje ————— 5

**01** Zgjedhjet për deputetë dhe këshilltarë ————— 6

I.1. Votuesit ..... 6

I.2. Subjektet politike dhe grupet e votuesve ..... 13

I.3. - Paraqitja e parashtruesve të listave zgjedhore dhe kandidatëve nga listat zgjedhore ..... 27

I.4. -Vëzhguesit e zgjedhjeve ..... 30

**02** Zgjedhjet për presidentin e Malit të Zi ————— 33

**03** Të drejtat sipas ligjit për listën e votuesve ————— 38

# Hyrje

Ky udhëzues është i dedikuar kryesisht votuesve, subjektëve që marrin pjesë në procesin zgjedhor, vëzhguesve, mediave, por edhe të tjerëve që janë të interesuar të mësojnë më shumë rreth procesit zgjedhor në Mal të Zi.

Ky është udhëzuesi i parë për zgjedhjet në të cilin jepet një shqyrtim të të gjitha çështjeve relevante të legjislationit zgjedhor pozitiv malazez dhe i cili u ofron subjekteve të interesuara një aspekt praktik kur bëhet fjalë për të drejtat dhe detyrimet e tyre në procesin zgjedhor.

Udhëzuesi është i natyrës informative dhe në të janë dhëna përgjigjet e pyetjeve pa interpretuar kuptimin e dispozitave individuale. Arsyeja e kësaj qasjeje është që udhëzuesi të jetë më konciz dhe jo i rënduar me finesat ligjore që nuk janë në fokusin e interesit të atyre për të cilët është synuar. Në të njëjtën kohë, përgjigjet janë të përmbledhura dhe konkrete për të gjitha pyetjet kyçe të rregulluara me rregulloren pozitive, e që kanë të bëjnë me procedurën e zgjedhjeve.

Udhëzuesi është i ndarë në tri pjesë. I pari i referohet zgjedhjeve për zgjedhjen e deputetëve dhe këshilltarëve, e dyta për zgjedhjet presidenciale, ndërsa pjesa e tretë i referohet të drejtave të përcaktuara me Ligjin për Listën e Votuesve. Meqenëse për zgjedhjen e Presidentit të Malit të Zi zbatohen dispozitat e Ligjit për Zgjedhjen e Këshilltarëve dhe Deputetëve, pjesa e dytë e Udhëzuesit ofron një pasqyrë të vetëm atyre dispozitave që janë të rregulluara ndryshe në lidhje me zgjedhjet për deputetë dhe këshilltarë.

Pjesa e parë e udhëzuesit është e ndarë në mënyrë tematike në katër njësi për ta bërë më të lehtë gjetjen e përgjigjeve. Në kuadër të kësaj pjese të udhëzuesit, njësia e parë i referohet të drejtave dhe detyrimeve të zgjedhësve në procesin zgjedhor, e dyta të drejtave dhe detyrimeve të subjekteve politike të interesuara për të marrë pjesë në zgjedhje, ndërsa njësia e tretë jep përgjigje për pyetjet që lidhen me përfaqësimin në media. Njësia e fundit trajton çështje të rëndësishme për punën e vëzhguesve vendas dhe të huaj.

Votimi zhvillohet në bazë të të drejtës univerzale dhe të barabartë të votës, në zgjedhje të drejtpërdrejta dhe të lirë me votë të fshehtë.

# 01 Zgjedhjet për deputetë dhe këshilltarë

## I.1. VOTUESIT

### **Kush ka të drejtën e votës?**

Të drejtën e votës në zgjedhjet për deputetë dhe këshilltarë kanë qytetarët që kanë nënshtetësinë malazeze dhe janë të regjistruar në regjistrin e votuesve.

### **Cilat janë parimet themelore të ushtrimit të së drejtës së votës në sistemin zgjedhor malazez?**

Votimi zhvillohet në bazë të të drejtës univerzale dhe të barabartë të votës, në zgjedhje të drejtpërdrejta dhe të lirë me votë të fshehtë.

### **Cilat janë kushtet që një person mund të zgjedhë apo të zgjidhet për deputetë?**

Të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet për deputetë ka votuesi që ka mbushur 18 vjet dhe ka vendbanimin në Mal të Zi të paktën dy vjet para ditës së zgjedhjeve.

### **Cilat janë kushtet që një person mund të zgjedhë apo të zgjidhet për këshilltarë?**

Të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet për këshilltarë ka votuesi që ka mbushur 18 vjet dhe ka vendbanimin në Mal të Zi të paktën dy vjet dhe ka vendbanimin në komunë ose në qytezë, që është njësi zgjedhore.

### **Çfarë nënkuptohet me të drejtën e votës?**

E drejta e votës, sipas këtij ligji, përfshinë këta të drejta të votuesve: të zgjedhin dhe të jenë të zgjedhur; të kandidojnë dhe të jenë të kandiduar; të vendosin për kandidatët e propozuar dhe listat zgjedhore; ti bëjnë publikisht pyetje kandidatëve; të informohen në kohë, në mënyrë të saktë, të plotë dhe objektivisht për programet dhe aktivitetet e parashtruesve të listave zgjedhore dhe për kandidatët nga ato lista, si dhe të kenë të drejtat e tjera të parashikuara në Ligjin për Zgjedhjen e Këshilltarëve dhe Deputetëve.

## **A mundet votuesi të thuret në përgjegjësi për shkak të votës?**

Askush nuk mundet, mbi çfarëdo baze, të thërrasë votuesin për të dhënë llogari për votën, as t'i kërkojë të thotë se për kë ka votuar ose pse nuk ka votuar.

## **Kur mbahen zgjedhjet?**

Zgjedhjet mbahen gjithmonë të dielën, me përjashtim të rastit të zgjedhjeve të përsëritura në një qendër të caktuar votimi, kur ato mund të mbahen edhe në ditë pune.

## **Kur hapen dhe mbyllen qendrat e votimit?**

Qendrat e votimit në njësinë zgjedhore hapen në orën 07:00 dhe mbyllen në orën 20:00.

## **Si informohen votuesit për mbajtjen e zgjedhjeve?**

Ministria përgjegjëse për listat e votuesve ua dërgon votuasve njoftimin për zgjedhjet, jo më vonë se shtatë ditë para ditës së zgjedhjeve. Megjithatë, dorëzimi i këtij njoftimi nuk është kusht për ushtrimin e të drejtës së votës.

## **Çfarë përmban njoftimi për zgjedhjet?**

Njoftimi duhet të jetë gjithashtu në format të aksesueshëm për votues me aftësi të kufizuara dhe të përmbajë: ditën dhe orën e zgjedhjeve, numrin dhe adresën e qendrës së votimit ku votohet dhe numrin në të cilin votuesi është regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve.

## **A egziston ndonjë mënyrë tjetër që votuesi të informohet për qendrën e votimit ku voton?**

Votuesi mund të kontrollojnë se ku votonë duke telefonuar në numrin 19820, i cili është aktiv gjatë periudhës së zgjedhjeve, ose duke futur të dhënat personale në uebsajtin <http://www.biraci.me/>.

## **Ku voton votuesi?**

Votuesi mund të votojë vetëm në qendrën e votimit ku është shënuar në ekstraktin nga lista e votuesve.



Votuesi që dëshiron të votojë përmes letrës i paraqet këshillit zgjedhor në formularin e caktuar kërkesën për votim përmes letrës, të cilën është i detyruar ta nënshkruajë personalisht.

### **A mund të votojë një votues jashtë qendrës së votimit?**

Votuesi mund të votojë jashtë qendrës së votimit përmes letrës, për shkak të moshës, paaftësisë, trajtimit spitalor ose shtëpiak, ose në qoftë se nuk është në gjendje të votojë në qendrën e votimit ku është shënuar në ekstraktin nga lista e votuesve.

### **Cila është procedura e votimit përmes letrës?**

Votuesi që dëshiron të votojë përmes letrës i paraqet këshillit zgjedhor në formularin e caktuar kërkesën për votim përmes letrës, të cilën është i detyruar ta nënshkruajë personalisht. Ajo kërkesë dorëzohet në këshillin e votimit në vendvotim, jo më vonë se në ora 13:00 të ditës së votimit dhe mund ta paraqesë vetëm personi të cilin e autorizon kërkuesi me nënshkrim për të votuar përmes letrës. Një person nuk mund të paraqesë më shumë se një kërkesë për votim përmes letrës këshillit zgjedhor, me përjashtim të rastit kur dy ose më shumë votues që votojnë përmes letrës jetojnë në të njëjtën shtëpi familjare. Së bashku me kërkesën për votim përmes letrës dhe autorizimin për paraqitjen e kërkesës, këshillit zgjedhor i dorëzohet edhe letërnjoftimi ose pasaporta e votuesit që dëshiron të votojë përmes letrës.

### **A mund të votojë një votues jashtë vendit, pra në zyrat përfaqësuese diplomatike dhe konsullore të Malit të Zi?**

Legjislacioni malazez nuk parashikon mundësinë e votimit për votuesit jashtë vendit.

### **Si funksionon procedura e votimit në qendrën e votimit?**

Votuesi njofton këshillit zgjedhor për emrin dhe mbiemrin e vet dhe e vërteton identitetin me letërnjoftim ose pasaportë. Një votues nuk mund të votojë pa paraqitur dëshmi identiteti. Kryetari i këshillit zgjedhor e gjen votuesin në ekstraktin elektronik dhe të printuar nga lista e votuesve, votuesi

nënshkruhet në vendin e parashikuar në ekstraktin nga lista e votuesve, duke vërtetuar se e ka marrë fletën e votimit, dhe pastaj këshilli zgjedhor e lejon të votojë. Pasi konfirmon identitetin e votuesit, kryetari ose anëtari i këshillit zgjedhor rrethon numrin rendor me të cilin është regjistruar votuesi në ekstraktin nga lista e votuesve, i shpjegon mënyrën e votimit dhe i dorëzon fletën e votimit.

Anëtarët e këshillit zgjedhor janë të detyruar t'i shpjegojnë votuesit, me kërkesë të tij, mënyrën e votimit përsëri.

Një votues mund të votojë vetëm një herë gjatë zgjedhjeve.

### **A duhet votuesi të votojë personalisht?**

Çdo votues, sipas rregullit, voton personalisht. Megjithatë, votuesi i cili për shkak të paarritshmërisë së qendrës së votimit, informacionit dhe komunikimit (person me aftësi të kufizuara) ose analfabetizmit (person analfabet) nuk është në gjendje të votojë personalisht në qendrën e votimit, ka të drejtë ta bëjë këtë me ndihmën e një asistenti të caktuar prej tij, i cili është i detyruar të plotësojë fletën e votimit, gjegjësisht të votojë në mënyrën e udhëzuar nga votuesi.

Votimin për votuesin nuk mund ta bëjë anëtari i këshillit zgjedhor e as përfaqësuesi i autorizuar i parashtruesit të listës zgjedhore.

### **Si votohet saktë në një qendër votimi?**

Pas marrjes së fletëvotimit të vërtetuar, votuesi shkon në zonën e caktuar të votimit dhe voton në mënyrë të fshehtë që të mos shihet se për kë ka votuar.

Votuesi mund të votojë vetëm për një listë zgjedhore në fletëvotim. Votohet duke rrethuar numrin rendor përpara emrit të listës zgjedhore për të cilën votohet, pra duke rrethuar emrin e listës ose emrin dhe mbiemrin e bartësit të listës.

Votuesi palos vetë fletën e votimit të plotësuar në mënyrë që të mos shihet se si ka votuar, ndërsa kuponin e kontrollit e lë të lirë, dhe pastaj duke mbajtur në dorë fletën e votimit të palosur, shkon tek kutia e votimit dhe lejon anëtarin e caktuar nga këshilli zgjedhor që në vendin e shpuar

të ndajë kuponin e kontrollit nga fleta e votimit. Votuesi më pas vendos fletën e votimit në kutinë përkatëse të votimit dhe largohet nga qendra e votimit.

### **Cila është procedura nëse votuesi shkel fshehtësinë e votës?**

Nëse votuesi shkel fshehtësinë e votës duke votuar publikisht jashtë zonës së caktuar për votim ose nëse pas votimit në zonën e caktuar ku votohet, ia tregon publikisht fletën e votimit këshillit zgjedhor në mënyrë që të shihet se për kë ka votuar, Kryetari i këshillit zgjedhor, në bazë të vendimit të mëparshëm të këshillit zgjedhor, është i detyruar që në prani të këshillit zgjedhor, pasi ta ndajë kuponin e kontrollit, fletën e votimit ta bëj të pavlefshme duke e kryqëzuar atë dhe duke e paketuar në zarf të veçantë dhe duke e futur në kutinë e votimit në vend të votuesit.

### **A mundet votuesi të votojë pas orës 20:00 apo pas mbylljes së qendrave të votimit?**

Votuesve do t'u lejohej të votojnë nëse kanë qenë në qendrën e votimit kur është mbyllur. Këshilli zgjedhor paraprakisht përcakton numrin dhe identitetin e atyre votuesve.

### **Në cilën mënyrë mundet votuesi të mbështesë listën zgjedhore në procesin e kandidimit?**

Votuesi me nënshkrimin e tij mund të mbështesë vetëm një listë zgjedhore për zgjedhjen e këshilltarëve dhe vetëm një listë zgjedhore për zgjedhjen e deputetëve.

### **Si arrihet mbrojtja e të drejtës së votës?**

Çdo votues ka të drejtë të ankohet për shkak të cenimit të së drejtës së votës gjatë zgjedhjeve.

### **Kujt i drejtohet ankesa?**

Kundër vendimit, veprimit ose mosveprimit të këshillit zgjedhor, kundërshtimi i paraqitet Komisionit Komunal Zgjedhjeve.

Kundër vendimit, veprimit ose mosveprimit të Komisionit Komunal

Zgjedhor kundërshtimi i paraqitet Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Kundër vendimit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve mundet të çohet ankesa në Gjykatën Kushtetuese.

### **Kundër çfarë zgjidhjesh mund të paraqesë votuesi kundërshtim/ankesë?**

Kundër vendimit të Komisionit Komunal Zgjedhor ku është hedhur poshtë ose është refuzuar kundërshtimi, mund të bëhet kundërshtimi tek Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.

Kundër vendimit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve ku është hedhur poshtë ose është refuzuar kundërshtimi, mund të bëhet ankesa në Gjykatën Kushtetuese të Malit të Zi.

Kundërshtimi apo ankesa nuk mund të bëhen kundër vendimeve në raste kur është pranuar ankesa.

### **Cili është afati kohor për paraqitjen e kundërshtimeve/ankesave?**

Kundërshtimi paraqitet brenda 72 orëve nga koha kur është marrë vendimi, pra kur është kryer veprimi.

Ankesa i paraqitet Gjykatës Kushtetuese brenda 48 orëve nga dita e marrjes së vendimit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.



# 48h

orë nga dita e marrjes së vendimit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve është afati për paraqitjen e ankesës në Gjykatën Kushtetuese

## **I.2. SUBJEKTET POLITIKE DHE GRUPET E VOTUESVE**

### **Në çfarë mënyre subjektet politike mund të marrin pjesë në organet për zbatimin e zgjedhjeve?**

Subjektet politike mund të propozojnë anëtarë të organeve për zbatimin e zgjedhjeve (Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, komisionet komunale zgjedhore, këshillet zgjedhore) të cilët në varësi të rezultateve të zgjedhjeve, gjegjësisht faktit nëse lista zgjedhore është konfirmuar, kanë të drejtë të marrin pjesë në organet për zbatimin e zgjedhjeve në përbërje e përhershme ose të zgjeruar.

### **Cilat subjekte politike kanë të drejtë të jenë anëtarë të përhershëm të Komisionit Shtetëror Zgjedhor?**

Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) është institucioni qendror i procesit zgjedhor, i cili në mënyrë të përhershme përbëhet nga kryetari dhe 10 anëtarë.

Nëntë anëtarë të KSHZ-së janë përfaqësues të partive politike të përfaqësuara në Parlamentin e Malit të Zi sipas rezultateve zgjedhore. Katër anëtarë zgjidhen nga radhët e shumicës parlamentare, katër nga opozita, ndërsa një anëtar zgjidhet si përfaqësues i një partie politike, përkatësisht parashtruesi i listës zgjedhore për përfaqësimin autentik të anëtarëve të kombit pakicë ose komunitetit kombëtar pakicë, të cilët kanë marrë numrin më të madh të votave në zgjedhjet e mëparshme. Një anëtar i KSHZ-së zgjidhet nga shoqëria civile, sektorit joqeveritar dhe universitetit.

### **Sa zgjat mandati i anëtarëve të KSHZ-së në përbërjen e përhershme dhe kur zgjidhen?**

Anëtarët e përhershëm të KSHZ-së zgjidhen pas zgjedhjeve parlamentare dhe mandati i zgjat katër vjet.

**Kushti i vetëm i parashikuar që një person të jetë anëtar i KSHZ-së në përbërje të përhershme dhe të zgjeruar para subjekteve politike është që personi të jetë i diplomuar në drejtësi.**

**Cilat subjekte politike kanë të drejtë të jenë anëtarë të KSHZ-së në përbërjen e zgjeruar?**

Të gjithë parashtruesit e listave zgjedhore të cilëve KSHZ-ja ia konfirmon listën zgjedhore kanë të drejtë të caktojnë përfaqësuesin në përbërjen e zgjeruar dhe KSHZ-ja e përcakton këtë në konkluzion dhe e dorëzon brenda 24 orëve nga miratimi i tyre.

**Që kur zgjat mandati i anëtarëve të KSHZ-së në përbërjen e zgjeruar dhe kur përfundon ai?**

Përfaqësuesit e autorizuar marrin pjesë në punë dhe marrin vendime të vlefshme 20 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve. Mandati i tyre përfundon ditën që përcaktohen rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve.

**Cilat janë kushtet që një person të jetë anëtar i KSHZ-së në përbërjen e përhershme dhe të zgjeruar para subjekteve politike?**

Kushti i vetëm i parashikuar është që personi të jetë i diplomuar në drejtësi.

### **Cilat subjekte politike kanë të drejtë të jenë anëtarë të përhershëm të Komisionit Komunal Zgjedhor?**

Komisioni Komunal Zgjedhor përbëhet nga: kryetari dhe katër anëtarë të përhershëm dhe një përfaqësues të autorizuar të parashtruesit të listës zgjedhore. Kryetar emërohet kandidati i partisë politike, përkatësisht parashtruesi i listës zgjedhore që ka fituar numrin më të madh të mandateve të këshilltarëve në zgjedhjet e mëparshme. Nëse lista zgjedhore e një koalicionit ka marrë numrin më të madh të mandateve në zgjedhjet e mëparshme, si rregull, kryetar i komisionit komunal zgjedhor emërohet kandidati i partisë politike që ka marrë numrin më të madh të mandateve të këshilltarëve brenda koalicionit. Dy anëtarë të përbërjes së përhershme të Komisionit Komunal Zgjedhor emërohen me propozim të opozitës parlamentare dhe proporcionalisht me numrin e mandateve të fituara në zgjedhjet e mëparshme. Në rastin e numrit të njëjtë të mandateve, lista zgjedhore që ka marrë më shumë vota ka prioritet.

Kryetarit dhe anëtarëve të komisionit zgjedhor komunal në përbërje të përhershme u emërohen zëvendësit.

### **Po sikur në kuvendin komunal të përfaqësohet vetëm një subjekt zgjedhor opozitar?**

Nëse në kuvendin komunal ka vetëm një listë zgjedhore opozitare, të dy anëtarët e përbërjes së përhershme të Komisionit Komunal Zgjedhor emërohen me propozimin e asaj liste zgjedhore të opozitës.

### **Kujt i përket vendi i sekretarit të Komisionit Komunal Zgjedhor?**

Sekretari i Komisionit Komunal Zgjedhor emërohet me propozim të opozitës parlamentare dhe, si rregull, është kandidati i listës zgjedhore të opozitës që ka marrë numrin më të madh të mandateve të këshilltarëve në zgjedhjet e mëparshme.

### **A ka të drejtë të votojë apo të marrë vendime sekretari i Komisionit Komunal Zgjedhor në seancat e Komisionit Komunal Zgjedhor?**

Sekretari i Komisionit Komunal Zgjedhor është përgjegjës për zbatimin e punëve administrative të parashikuara nga legjislati i zgjedhor dhe nuk ka të drejtë të marrë vendime.

### **Cilat subjekte politike mund të jenë anëtarë të Komisionit Komunal Zgjedhor në përbërjen e zgjeruar?**

Të gjithë parashtruesit e listave zgjedhore, lista zgjedhore e të cilëve është konfirmuar nga komisioni komunal zgjedhor, kanë të drejtë të caktojnë përfaqësues në përbërjen e zgjeruar, të cilën Komisioni Komunal Zgjedhor e përcakton me konkluzion dhe e dorëzon brenda 24 orëve nga miratimi i tyre.

### **Sa anëtarë ka këshilli zgjedhor?**

Këshilli zgjedhor përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë



të përhershëm dhe një përfaqësues i autorizuar i parashtruesit të listës zgjedhore.

### **Kush ka të drejtë të delegojë në këshillin zgjedhor në përbërje të përhershme?**

Çdo parti politike e përfaqësuar në kuvendin përkatës ka numrin e kryetarëve të këshilleve zgjedhore në përpjesëtim me përfaqësimin proporcional të vendeve të këshilltarëve në kuvend, ndërsa vendotimet ku një parti politike individuale do të emëronte përfaqësuesit për kryetarin e këshillit të votimit përcaktohen me short nga komisioni komunal zgjedhor.

Në përbërjen e përhershme të këshillit zgjedhor duhet të emërohet në kuvendin përkatës nga një përfaqësues i dy partive politike opozitare të cilat kanë marrë numrin më të madh të mandateve në zgjedhjet e mëparshme, dhe në rastin e të njëjtit numër mandatesh, numrin më të madh të votave.

Nëse në kuvendin përkatës komunal ka vetëm një parti politike opozitare, në përbërjen e përhershme të këshillit zgjedhor emërohen dy përfaqësues të asaj partie.

### **Kur emërohet këshilli zgjedhor?**

Këshilli zgjedhor caktohet për çdo vendvotim, jo më vonë se 10 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve. Përrjashtimisht, me kërkesë të arsyetuar të një partie politike, përkatësisht të një grupi votues që ka fituar të drejtën për të emëruar përfaqësues në përbërjen e përhershme të këshillit zgjedhor, përbërja e këshillit zgjedhor mund të ndryshohet edhe pas skadimit të këtij afati, jo më vonë se 12 orë para hapjes së qendrave të votimit.

### **Kush ka të drejtë të emërojë një anëtar të këshillit zgjedhor në përbërjen e zgjeruar?**

Komisioni Komunal Zgjedhor, në ditën e marrjes së vendimit për shpalljen e listës zgjedhore, përcakton me konkluzion se cili parashtrues i listës zgjedhore i plotëson kushtet për emërimin e përfaqësuesve të tij në përbërjen e zgjeruar të këshillit zgjedhor. Komisioni Komunal Zgjedhor ia dorëzon konkluzionin për plotësimin ose mosplotësimin e kushteve për emërimin e përfaqësuesit të parashtruesit të listës zgjedhore në përbërjen e zgjeruar të këshillit zgjedhor parashtruesit të listës zgjedhore, brenda 24 orëve nga momenti i përcaktimit së qendres të votimit.

Parashtruesi i listës zgjedhore cakton përfaqësuesin e tij të autorizuar në përbërjen e zgjeruar të këshillit zgjedhor dhe për këtë e informon Komisionin Komunal Zgjedhor, i cili jo më vonë se 24 orë pas njoftimit, cakton me emër personat që hyjnë në përbërjen e zgjeruar të këshillit zgjedhor.

### **Kur anëtari i këshillit zgjedhor fillon të marrë pjesë në punë dhe të marrë vendime?**

Përfaqësuesi i autorizuar merr pjesë në punë dhe merr vendime të vlefshme pesë ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve.

### **Çfarë dokumentesh dorëzojnë partitë politike në komisionin zgjedhor kompetent për konfirmimin e listës?**

Së bashku me listën zgjedhore, komisionit zgjedhor i dorëzohen dokumentet në vazhdim:

- 1) deklarata me shkrim e kandidatit se e pranon kandidaturën;
- 2) vërtetimi i të drejtës së votës për secilin kandidat nga lista zgjedhore;

- 3) vërtetimi i vendbanimit të secilit kandidat;
- 4) listën me nënshkrimet e votuesve që mbështesin listën zgjedhore;
- 5) pëlqimi me shkrim për pranimin e bartësit të listës, nëse ajo është e përfshirë në emër të listës;
- 6) vendimin e organit kompetent të partisë politike që ka verifikuar listën zgjedhore;
- 7) aplikimi për zgjedhje;
- 8) akti themelues dhe programor.

### **Cili është ndryshimi kur bëhet fjalë për grupe votuese në lidhje me dokumentacionin e kërkuar?**

Duke marrë parasysh se grupet votuese nuk duhet të kenë statut dhe akt formal programor, ato së bashku me listën zgjedhore paraqesin deklaratën e vërtetuar nga organi kompetent për vendimin për pjesëmarrje në zgjedhje me qëllimet programore të listës zgjedhore, personit të autorizuar për përfaqësim para organeve kompetente, si dhe të drejta dhe detyrimet e tjera të ndërsjella.

Së bashku me emrin e listës zgjedhore të grupit të votuesve, parashtruesi specifikon një përcaktim më të afërt të asaj liste.

### **Cilat janë afatet për dorëzimin e listës zgjedhore?**

Lista zgjedhore për zgjedhjen e këshilltarëve i dorëzohet Komisionit Komunal Zgjedhor, ndërsa për zgjedhjen e deputetëve KSHZ-së jo më herët se 20 ditë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve dhe jo më vonë se 25 ditë para ditës së zgjedhjeve.

### **Çka nëse lista zgjedhore është dorëzuar me vonesë?**

Nëse komisioni kompetent zgjedhor konstaton se lista zgjedhore nuk është dorëzuar në kohë, do të marrë vendim me të cilin e refuzon atë listë.



0,8%

është përqindja minimale e nënshkrimeve të mbështetjes së zgjedhësve në njësinë zgjedhore që kërkohet për përcaktimin e listës zgjedhore për zgjedhjen e këshilltarëve

### **Çka nëse dokumentacioni është i paplotë ose lista zgjedhore ka mangësi?**

Nëse komisioni kompetent zgjedhor konstaton se lista zgjedhore përmban disa mangësi, brenda 48 orëve nga marrja e listës zgjedhore, me konkluzion e urdhëron parashtruesin e listës t'i eliminojë ato mangësi, jo më vonë se 48 orë pas dorëzimit të konkluzionit. Me këtë konkluzion, parashtruesit i tregohet për veprimet që duhet të kryejë për të eliminuar mangësitë.

### **Çka nëse parashtruesi i listës zgjedhore nuk i eliminon mangësitë brenda afatit të caktuar?**

Nëse komisioni kompetent zgjedhor konstaton se mangësitë e listës zgjedhore nuk janë korrigjuar ose nuk janë korrigjuar brenda afatit të caktuar, në 24 orët e ardhshme do të nxjerrë vendim me të cilin refuzohet shpallja e asaj liste zgjedhore.

### **Sa është numri i kërkuar i nënshkrimeve të mbështetjes së votuesve për listën zgjedhore?**

Lista zgjedhore për zgjedhjen e këshilltarëve, gjegjësisht deputetëve, mund të përcaktohet nëse e mbështesin me nënshkrime të paktën 0,8% e votuesve nga numri i votuesve në njësinë zgjedhore, duke llogaritur sipas të dhënave për numrin e votuesve nga zgjedhjet që i kanë paraprirë vendimit për shpalljen e zgjedhjeve, pavarësisht nëse bëhet fjalë për zgjedhjet për presidentin e Malit të Zi apo për zgjedhjet për Parlament.

### **Cili është numri i kërkuar i nënshkrimeve për partitë dhe grupet e votuesve që përfaqësojnë pakicat dhe komunitetet kombëtare pakicë?**

Përpartitë politike ose grupet e votuesve që përfaqësojnë një popull pakicë ose komunitet kombëtar pakicë, lista zgjedhore për zgjedhjen e këshilltarëve mund të konfirmohet nëse me nënshkrimet e tyre e mbështesin së paku 150 votues, ndërsa për zgjedhjen e deputetëve mund të përcaktohet nëse ajo mbështetet nga të paktën 1000 votues.

Në komunat ku në zgjedhjet e mëparshme mandati i këshilltarit ishte i barabartë ose më pak se 150 vota, lista zgjedhore për zgjedhjen e këshilltarëve mund të konfirmohet nëse numri i zgjedhësve që e mbështesin me nënshkrimin e tyre është më pak se numri i votave që ishin të vlefshme për mandatin e një këshilltari në zgjedhjet e mëparshme për kuvendin komunal përkatës.

Lista zgjedhore për zgjedhjen e deputetëve që përfaqësojnë popullin pakicë ose një komunitet kombëtar pakicë me pjesëmarrje deri në 2% në popullsinë e përgjithshme të Malit të Zi sipas rezultateve të regjistrimit të fundit, mund të përcaktohet nëse e mbështesin të paktën 300 votues me nënshkrimet e tyre.

### **Kush mund të japë nënshkrim mbështetëje dhe a ka ndonjë kufizim?**

Nënshkrimet mbështetëse mund të jepen nga të gjithë personat që kanë të drejtë vote. Kufizimet i referohen faktit që votuesit që nënshkruajnë mbështetjen për listat për zgjedhjen e këshilltarëve duhet të kenë vendbanimin në territorin e komunës përkatëse, ndërsa votuesit që nënshkruajnë mbështetjen për listat për zgjedhjen e deputetëve duhet të kenë vendbanimin në territorin e Malit të Zi.

### **Kush i propozon kandidatët në listën zgjedhore dhe cakton radhën e tyre?**

Në Mal të Zi janë në fuqi listat e mbyllura zgjedhore, që do të thotë se votuesit bëjnë zgjedhje për listë dhe jo për kandidatë individualë. Prandaj, partitë politike, veçmas ose si koalicion, si dhe grupe votuesish, propozojnë kandidatë për listën e tyre zgjedhore dhe përcaktojnë radhën e kandidatëve në listë.

### **Cilat janë kushtet që një person të jetë kandidat në listën zgjedhore?**

Votuesi që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe ka vendbanimin në Mal të Zi të paktën dy vjet para ditës së zgjedhjeve ka të drejtë të votojë dhe të zgjidhet deputet.

E drejta të votojë dhe të zgjidhet si këshilltar ka votuesi që ka mbushur moshën 18 vjeç, që ka vendbanimin në Mal të Zi për të paktën dy vjet dhe që ka vendbanimin në një komunë, ose në komunën e qytetit, si njësi zgjedhore.

### **Cilat janë kufizimet e parashikuara kur bëhet fjalë për kandidimin në listën zgjedhore?**

Një person mund të jetë kandidat për këshilltar vetëm në një listë zgjedhore dhe vetëm në një njësi zgjedhore.

Një person mund të jetë kandidat për deputet vetëm në një listë zgjedhore.

### **Sa kandidatë propozojnë parashtruesit e listës zgjedhore në listë?**

Një listë zgjedhore mund të ketë të paktën 2/3 dhe maksimum aq kandidatë sa duhet zgjedhur. Përrjashtimisht, në listën zgjedhore për zgjedhjen e deputetëve të paraqitur nga grupe votuesish ose parti politike që përfaqësojnë një popull pakicë ose një komunitet kombëtar pakicë, mund

Kandidati mund të tërheqë kandidaturën deri në ditën e marrjes së vendimit për shpalljen e listës zgjedhore.

të kenë së paku 1/3 dhe maksimumi aq kandidatë sa duhet zgjedhur.

### **Cilat janë kushtet për paraqitjen e listës që ka të bëjë me realizimin e parimit të barazisë gjinore?**

Ligji parashikon që 30% e kandidatëve të gjinisë më pak të përfaqësuar duhet të jenë në listën zgjedhore.

Përveç kësaj dispozite, ligjebërësi parashikoi një normë shtesë mbrojtëse, duke parashikuar se çdo i katërti kandidatë sipas renditjes në listë (katër vendet e para, katër vendet e dyta e kështu me radhë deri në fund të listës) duhet të jetë së paku një kandidat që i përket gjinisë më pak të përfaqësuar.

### **Çka nëse lista zgjedhore nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në lidhje me përfaqësimin e grave?**

Në atë rast, komisioni kompetent zgjedhor fton parashtruesin të eliminojë mangësitë brenda 48 orëve. Nëse parashtruesi nuk i eliminon mangësitë, komisioni zgjedhor nuk do ta shpallë listën zgjedhore.

### **Deri kur mundet parashtruesi i listës zgjedhore ta tërheqë listën?**

Parashtruesi i listës zgjedhore mund ta tërheqë listën jo më vonë se data e përcaktimit të listës përmbledhëse zgjedhore.

### **Cilat janë pasojat e tërheqjes së listës lidhur me përfaqësuesit në organet për zbatimin e zgjedhjeve?**

Me tërheqjen e listës zgjedhore përfundon funksioni i përfaqësuesit të autorizuar të parashtruesit të listës në të gjitha organet për zbatimin e zgjedhjeve, si dhe të

gjitha të drejtat që i takojnë në atë cilësi, sipas përcaktimeve të ligjit.

### **Deri kur një kandidat mund të tërheqë kandidaturën?**

Kandidati mund të tërheqë kandidaturën deri në ditën e marrjes së vendimit për shpalljen e listës zgjedhore.


### **Çka nëse kandidati humb shtetësinë malazeze, fshihet nga regjistri i vendbanimit, ose nëse vdes?**

Në atë rast, parashtruesi i listës zgjedhore humb të drejtën të propozojë kandidat të ri, dhe pozitën në listë e zë kandidati i radhës në listën zgjedhore.

### **Si i rregullojnë të drejtat e njëri-tjetrit përbërësit e listës zgjedhore të koalicionit?**

Nëse dy ose më shumë parti politike ose grupe votuesish paraqesin listën zgjedhore të koalicionit, emri, të drejtat dhe detyrimet e tjera të parashtruesve të listave zgjedhore





të koalicionit përcaktohen me marrëveshje që i dorëzohet komisionit zgjedhor kompetent në të njëjtën kohë me listën zgjedhore të koalicionit.

### **A duhet të jetë në listë mbajtësi i listës zgjedhore?**

Personi i caktuar si bartës i listës zgjedhore nuk duhet të jetë domosdoshmërisht kandidat në listë. Në emër të listës, parashtruesi i listës mund të përfshijë emrin dhe mbiemrin e bartësve të asaj liste, me pëlqimin e tyre me shkrim.

### **Si arrihet mbrojtja e të drejtës së votës?**

Parashtruesi i listës zgjedhore dhe kandidati nga lista kanë të drejtë të paraqesin kundërshtim ose ankesë për shkak të cenimit të së drejtës së votës gjatë zgjedhjeve.

### **Kujt i drejtohet kundërshtimi/ankesa?**

Kundër vendimit, veprimit ose mosveprimit të komisionit zgjedhor, kundërshtimi i paraqitet Komisionit Komunal Zgjedhor.

Kundër vendimit, veprimit ose mosveprimit të Komisionit Komunal Zgjedhor kundërshtimi i paraqitet kundërshtimi në KSHZ.

Kundër vendimit të KSHZ-së mund të parashtrohet ankesë në Gjykatën Kushtetuese.

### **Për cilat vendime parashtruesi i listës zgjedhore dhe kandidati mund të bëjnë kundërshtim/ankesë?**

Kundër vendimit të Komisionit Komunal Zgjedhor me të cilin është hedhur poshtë ose refuzuar kundërshtimi mund të parashtrohet ankesë në KSHZ.

Kundërvendimit të KSHZ-së me të cilin është hedhur poshtë ose refuzuar kundërshtimit mund të parashtrohet ankesë në Gjykatën Kushtetuese të Malit të Zi.

Kundër vendimit me të cilin pranohet kundërshtimi nuk mund të bëhet kundërshtim apo ankesë.

### **Cili është afati kohor për paraqitjen e kundërshtimit/ankesës?**

Kundërshtimi paraqitet brenda 72 orëve nga koha që është marrë vendimi, pra kur është kryer veprimi.

Ankesa parashtrohet në Gjykatën Kushtetuese në afat prej 48 orëve pas dorëzimit të vendimit të KSHZ-së.



### **I.3. - PARAQITJA E PARASHTRUESVE TË LISTAVE ZGJEDHORE DHE KANDIDATËVE NGA LISTAT ZGJEDHORE**

#### **Që kur fillon e drejta për të përfaqësuar kandidatët në listat zgjedhore dhe në cilat media?**

Parashtruesit e listave zgjedhore kanë të drejtë që nga dita e konfirmimit të listës zgjedhore deri në përfundimin e propagandës zgjedhore (në tekstin e mëtejshëm: fushata zgjedhore), përmes transmetuesit publik kombëtar Radio televizioni i Malit të Zi, si dhe përmes transmetuesve publik rajonal dhe lokal, të informojnë qytetarët për kandidatët, programet dhe aktivitetet e tyre brenda të njëjtave orare ditore, pra rubrikave, çdo ditë, për të njëjtën kohëzgjatje dhe pa pagesë.

#### **Cilat janë të drejtat e parashtruesëve të listave zgjedhore kur bëhet fjalë për transmetuesit komercialë?**

Parashtruesit e listave zgjedhore kanë të drejtë që, gjatë fushatës zgjedhore, në programe, gjegjësisht në rubrikat dhe hapësirat reklamuese të transmetuesve komercialë, të bëjnë promovim marketingu të kandidatëve dhe programeve të tyre dhe të publikojnë njoftime për tubimet e tyre promovuese, me pagesë, në përputhje me rregullat e miratuara nga transmetuesi. Transmetuesit komercialë janë të detyruar të ofrojnë reklama me pagesë me kushte të barabarta për të gjithë parashtruesit e listave të konfirmuara zgjedhore.

#### **Cilat janë kufizimet për paraqitjen e parashtruesve në listat zgjedhore?**

Për paraqitjen e listave zgjedhore nuk mund të përdoret prona (para, mjete teknike, hapësira, pajisje etj.) e organeve shtetërore, shoqërive publike, institucioneve dhe fondeve publike, njësisve të vetëqeverisjes lokale ose shoqërive në të cilat shteti ka aksione pronësore.

Zyrtarët publikë që emëron ose zgjedhë Qeveria e Malit të Zi ose që

emërohen ose zgjidhen nga vetëqeverisja lokale, nëpunësit civilë dhe nëpunësit shtetërorë nuk mund të marrin pjesë në fushatën zgjedhore dhe as të shprehin publikisht qëndrimet e tyre lidhur me zgjedhjet, gjatë orarit të punës, d.m.th. gjatë detyrës. Punonjësit e policisë dhe anëtarët e Agjencisë së Sigurisë Kombëtare nuk mund të marrin pjesë në asnjë mënyrë në fushatën zgjedhore.

### **Në çfarë termash dhe në çfarë kohe parashtuesit e listave zgjedhore kanë të drejtë të përfaqësohen në RTCG/RTMZ?**

Televizioni i Malit të Zi dhe Radio e Malit të Zi janë të obliguar që gjatë fushatës zgjedhore t'u ofrojnë në blloqe përkatëse të marketingut komercial në kanalin televiziv, gjegjësisht programin e Radios, parashtuesve të listave të konfirmuara zgjedhore, në mënyrë të barabartë dhe të përditshme, hapësirë falas për transmetimin e: - klipeve televizive politiko-propagande, ose audio reklama, në të gjitha blloqet e marketingut politik, në volum jo më pak se 200 sekonda në ditë, në varësi të numrit të planifikuar të reklamave- blloqeve të marketingut politik; - Raporte 3-minutëshe nga tubimi promovues, dy herë në ditë, në oraret menjëherë pas emisioneve informative të mbrëmjes qendrore në TV dhe Radio. Prodhimi i materialit bie në detyrimin e parashtuesit të listës zgjedhore që promovohet.

Televizioni i Malit të Zi dhe Radio e Malit të Zi janë të detyruar që gjatë fushatës zgjedhore, në kuadër të programit informativo - politik, të organizojnë dhe transmetojnë së paku dy emisione një orë e gjysmë të debatit ndërmjet parashtuesve të listave të konfirmuara zgjedhore dhe kandidatëve nga ato lista, nga ora 20:00 deri në 23:00, me marrëveshje të redaktorëve dhe parashtuesve të listave zgjedhore.

## **Cili është roli i Komisionit Parlamentar për Monitorimin e Zbatimit të Ligjit për Media?**

Komisioni është përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji që kanë të bëjnë me detyrimet e medias në fushatën parazgjedhore dhe në veçanti:

- 1) shqyrton kundërshtimet ndaj veprimeve të mediave dhe merr qëndrim për to dhe nxjerr përfundime;
- 2) paralajmëron mediat të veprojnë në sinkronim me këtë ligj dhe të eliminojnë parregullsitë e mundshme;
- 3) publikon opinionet dhe konkluzionet e veta;
- 4) informon Agjencinë për Media Elektronike dhe organet kompetente të mediave për shkeljet e dispozitave të ligjit nga ana e mediave, me qëllim që të ndërmerren masa nga juridiksioni i tyre ndaj mediave që veprojnë në kundërshtim me ligjin.

## **Kush ka të drejtë të marrë pjesë në Komision?**

Komisioni ka 10 anëtarë dhe është i përbërë në bazë të barazisë nga deputetët e shumicës parlamentare dhe opozitës parlamentare. Kryetari dhe zëvendëskryetari i Komisionit emërohen nga radhët e anëtarëve të Komisionit. Komisioni formohet jo më vonë se 10 ditë pas shpalljes së zgjedhjeve për deputetë. Propozimin për emërimin e kryetarit, zëvendëskryetarit dhe anëtarëve të Komisionit ia paraqet Kuvendit trup i punues i Kuvendit përgjegjës për zgjedhje dhe emërim.

Ligjbërësi ka definuar se përfaqësuesit e autorizuar të organizatave joqeveritare vendase mund të monitorojnë rrjedhën e zgjedhjeve dhe punën e organeve për zbatimin e zgjedhjeve.

## 1.4. - VËZHGUESIT E ZGJEDHJEVE

### **Kush mund të jetë vëzhgues vendas i zgjedhjeve sipas legjislacionit malazez?**

Ligji për Zgjedhjen e Këshilltarëve dhe Deputetëve parasheh që vëzhguesit vendas të zgjedhjeve mund të jenë përfaqësues të autorizuar të organizatave joqeveritare vendase që janë të regjistruara për monitorimin e realizimit të lirive dhe të drejtave politike.

### **Çfarë nënkuptohet me monitorimin e zgjedhjeve?**

Ligjbërësi ka definuar se përfaqësuesit e autorizuar të organizatave joqeveritare vendase mund të monitorojnë rrjedhën e zgjedhjeve dhe punën e organeve për zbatimin e zgjedhjeve.

### **Kujt i dorëzohet aplikimi për monitorimin e zgjedhjeve?**

Organizatave joqeveritare vendase të interesuara për monitorimin e zgjedhjeve paraqesin kërkesë në KSHZ.

### **Çfarë duhet të përmbajë aplikacioni për monitorimin e zgjedhjeve kur bëhet fjalë për vëzhguesit vendas të zgjedhjeve?**

Aplikimi përmban emrin e organizatës, dëshminë e regjistrimit në regjistër, numrin dhe përbërjen e përfaqësuesve vëzhgues.

### **Në çfarë periudhe vendos KSHZ për aplikimin?**

Komisioni Shtetëror Zgjedhor është i detyruar të lëshojë autorizime zyrtare brenda 48 orëve nga pranimi i kërkesës ose të refuzojë dhënien e autorizimit me vendim.

### **Cili është afati për paraqitjen e aplikimit për vëzhgim të zgjedhjeve në rastin e vëzhguesve vendas?**

Aplikimet dorëzohen jo më vonë se pesë ditë para ditës së votimit.

### **Kush mund të jetë vëzhgues i huaj i zgjedhjeve?**

Bashkimi Evropian, organizata të tjera ndërkombëtare, organizata ndërkombëtare joqeveritare dhe përfaqësuesit e autorizuar të shteteve të huaja.

### **Cila është përmbajtja e të drejtës për vëzhgimin e zgjedhjeve kur bëhet fjalë për vëzhguesit e huaj?**

Vëzhguesit e huaj mund të ndjekin rrjedhën e zgjedhjeve, që përfshin punën e organeve për zbatimin e zgjedhjeve dhe organeve të tjera shtetërore, monitorimin e fushatës zgjedhore nga mediat, ushtrimin e të drejtës së votës dhe të drejtat e tjera në lidhje me të drejtat politike dhe civile në procesin zgjedhor.

### **Cila është periudha e vëzhgimit të zgjedhjeve?**

Periudha e vëzhgimit fillon nga dita e shpalljes së zgjedhjeve dhe përfundon me publikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

### **Kujt i çojnë aplikimin për vëzhgim të zgjedhjeve vëzhguesit e huaj?**

Vëzhguesit e huaj të interesuar dorëzojnë kërkesë për vëzhgim të zgjedhjeve në ministrinë përgjegjëse për punë

të jashtme, e cila të nesërmen pas pranimit të aplikacionit ia dorëzon kërkesën KSHZ-së.

### **Cili është afati i fundit për paraqitjen e aplikimit?**

Vëzhguesit e huaj e paraqesin kërkesën e tyre jo më vonë se dhjetë ditë para ditës së zgjedhjeve.

### **Çfarë duhet të përmbajë aplikimi?**

Aplikimi duhet të përmbajë elementët në vazhdim: emrin e shtetit nga vjen vëzhguesi, emrin e organizatës, dëshminë e regjistrimit në regjistër, numrin dhe përbërjen e përfaqësuesve dhe kohën e qëndrimit.

### **Në cilën periudhë KSHZ-ja lëshon autorizime për vëzhgimin e zgjedhjeve?**

Në afat prej 48 orëve nga dita e pranimit të kërkesës, KSHZ-ja lëshon autorizim zyrtar për vëzhgim të zgjedhjeve, ose me vendim e refuzon dhënien e autorizimit.

### **Çfarë gjendet në kartën e identifikimit të lëshuar nga KSHZ?**

KSHZ-ja lëshon kartë identifikimi për vëzhguesit e huaj në të cilën shënohet emri, mbiemri, emri i shtetit nga vjen dhe emri i organizatës dhe institucionit të cilit i përkasin.

Personi të cilit i është lëshuar karta e identifikimit duhet ta mbajë atë në vend të dukshëm.

### **A mund të revokohet autorizimi i vëzhgimit të zgjedhjeve pasi është dhënë dhe pse?**

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve me propozim të organit për zbatimin e zgjedhjeve mund t'ia revokojë autorizimin ose kartën e identifikimit personit të cilit i është lëshuar nëse ai nuk respekton rregullat për mbajtjen e rendit në vendvotim, përkatësisht rregullat mbi punën e organit për zbatimin e zgjedhjeve.



# 02 Zgjedhjet për presidentin e Malit të Zi

Për zgjedhjen e Presidentit të Malit të Zi zbatohen dispozitat e Ligjit për Zgjedhjen e Këshilltarëve dhe Deputetëve në përputhje me: të drejtat e votës; përcaktimi dhe shpallja e listës së kandidatëve; prezantimi i kandidatëve; mënyra e organizimit të zgjedhjeve; forma dhe përmbajtja e fletës së votimit; votimi në vendvotim dhe jashtë qendrës së votimit dhe mbrojtja e të drejtës së votimit.

## **Kush ka të drejtë të zgjidhet për President të Malit të Zi?**

Të drejtën për t'u zgjedhur president ka shtetasi i Malit të Zi i cili ka mbushur moshën 18 vjeç dhe që ka vendbanimin në Mal të Zi të paktën 10 vjet në 15 vitet e fundit para ditës së zgjedhjeve.

## **Kush mund të propozojë kandidatin për president të Malit të Zi?**

Kandidatin për President mund ta propozojë një parti politike ose një grup qytetarësh. Një parti politike individuale ose grup qytetarësh mund të propozojnë vetëm një kandidat.

## **Sa nënshkrime mbështetëse nevojiten për kandidaturë të vlefshme?**

Kandidatura duhet të mbështetet nga të paktën 1.5% e votuesve nga numri i përgjithshëm i votuesve, duke llogaritur sipas të dhënave për numrin e votuesve nga zgjedhjet që i paraprinë vendimit për shpalljen e zgjedhjeve.

### **Sa kandidatë për president të Malit të Zi mund të mbështesë një votues?**

Votuesi me nënshkrimin e tij mund të mbështesë vetëm një kandidat.

### **Kujt i dorëzohet propozimi për kandidat për president të Malit të Zi dhe kur?**

Propozimi për kandidat për president i dorëzohet KSHZ-së jo më vonë se 20 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve.

### **Çfarë dokumentacioni duhet të dorëzohet?**

Me propozimin dorëzohet dokumentacioni në vazhdim:

- 1) deklaratën me shkrim të kandidatit se e pranon kandidaturën;
- 2) vërtetimin e të drejtës së votës të kandidatit;
- 3) vërtetimin e vendbanimit të kandidatit;
- 4) certifikatën e shtetësisë;
- 5) nënshkrimet e votuesve për mbështetjen e kandidatit.

### **Deri kur kandidati presidencial mund të heqë dorë nga kandidatura?**

Kandidati mund të tërhiqet nga kandidatura deri në përcaktimin e listës së kandidatëve.

### **Çfarë ndodh nëse njëri nga kandidatët vdes ndërmjet kohës së publikimit të listës dhe zgjedhjeve?**

Nëse njëri nga kandidatët vdes ndërmjet publikimit të listës dhe datës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve, partia politike mund të propozojë kandidatin e ri, me ç'rast nuk kërkohen nënshkrimet e votuesve dhe zgjedhjet shtyhen për 14 ditë.

### **Në cilën mënyrë voton votuesi drejt për kandidatin për president të Malit të Zi?**

Një votues mund të votojë vetëm për një kandidat. Votimi bëhet duke rrethuar numrin rendor përpara emrit dhe mbiemrit të kandidatit ose duke rrethuar emrin dhe mbiemrin e tij.

### **Cila fletë votimi do të konsiderohet e pavlefshme?**

Një fletë votimi konsiderohet e pavlefshme nëse:

- është e paplotë;
- plotësohet në mënyrë që nuk mund të përcaktohet me siguri se për cilin kandidat është votuar;
- votuesi ka votuar për dy ose më shumë kandidatë;
- është shkruar emri i personit që nuk është kandidat.

Nëse asnjë kandidat nuk merr numrin e votave, zhvillohet një raund i dytë zgjedhor për 14 ditë.

### **Cili kandidat zgjidhet për president të Malit të Zi?**

President zgjidhet kandidati që ka më shumë se gjysmën e votave të vlefshme të votuesve që votuan. Nëse asnjë kandidat nuk merr numrin e votave, zhvillohet një raund i dytë zgjedhor për 14 ditë.

### **Kush merr pjesë në raundin e dytë zgjedhor?**

Në raundin e dytë zgjedhor marrin pjesë dy kandidatët që kanë marrë numrin më të madh të votave dhe zgjidhet kandidati që ka marrë numrin më të madh të votave.

### **Po sikur të dy kandidatët të marrin numër të barabartë votash në raundin e dytë zgjedhor?**

Nëse të dy kandidatët marrin të njëjtin numër votash në raundin e dytë zgjedhor, votimi përsëritet ndërmjet dy kandidatëve brenda 7 ditëve.

### **Çka nëse njëri nga dy kandidatët që ka marrë më shumë vota në raundin e parë tërhiqet nga zgjedhjet?**

Nëse një nga kandidatët me numrin më të madh të votave në rrethin e parë tërhiqet nga zgjedhjet, të drejtën për të marrë pjesë në raundin e dytë zgjedhor e fiton kandidati që ka marrë numrin e radhës të votave në raundin e parë zgjedhor. Nëse në raundin e dytë zgjedhor mbetet vetëm një kandidat, për shkak të tërheqjes së kandidatëve të tjerë, ai kandidat konsiderohet i zgjedhur.

### **Po nëse njëri nga kandidatët që ka fituar të drejtën për të marrë pjesë në raundin e dytë zgjedhor, vdes para ditës së votimit?**

Nëse njëri nga kandidatët që ka të drejtë të marrë pjesë në raundin e dytë zgjedhor vdes para përfundimit të kohës së caktuar për votim, e gjithë procedura e zgjedhjes përsëritet dhe vendimi për shpalljen e zgjedhjeve merret brenda 14 ditëve nga data e vdekjes së kandidatit.

# 03 Të drejtat sipas ligjit për listën e votuesve

## **A mund të paraqesë votuesi kërkesë për ndryshim në listën e votuesve?**

Votuesi mund të paraqesë kërkesë për ndryshim në listën e votuesve te organi përgjegjës për mbajtjen e listës zgjedhore - Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB).

Ndryshimet në listën e votuesve me kërkesë të votuesit bëhet në bazë të të dhënave ose dokumenteve publike të paraqitura nga kërkuesi, pra të dhënave nga regjistrat elektronikë ose regjistrat e mbajtur sipas ligjit.

## **Pse një votues mund të kërkojë ndryshim në listën e votuesve?**

Votues mund të kërkojë ndryshim në listën e votuesve nëse:

- 1) nuk është i regjistruar në listën e votuesve;
- 2) të dhënat për të në listën e votuesve janë të pasakta ose të paplota;
- 3) të dhënat për vendvotimin ku votuesi ka të drejtë vote nuk janë futur ose janë futur gabimisht.

Bashkë me kërkesën zgjedhësi paraqet prova që lidhen me lëndën e kërkesës së tij për të bërë ndryshim të caktuar në listën e votuesve.

Vendimi duhet të merret nga Ministria brenda 48 orëve nga marrja e kërkesës dhe i dorëzohet aplikantit pa vonesë.

Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, kërkesa nga paragrafi 1 i këtij neni mund t'i paraqitet Ministrisë jo më vonë se 15 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve.

**Po nëse MPB-ja konstaton se kërkesat janë të bazuara?**

Me vendim, Ministria do të bëjë ndryshimin përkatës në regjistrin origjinal dhe do ta shënojë automatikisht atë ndryshim në listën e votuesve ose do të korrigjojë të dhënat në qendrën e votimit ku voton votuesi dhe do të bëjë ndryshim tjetër në listën e votuesve dhe regjistrin përkatës origjinal në të cilin ndryshimi i referohet.

**Në çfarë afati kohor merr vendimin MPB-ja?**

Vendimi duhet të merret nga Ministria brenda 48 orëve nga marrja e kërkesës dhe i dorëzohet aplikantit pa vonesë.

**Çka nëse Ministria e Brendshme refuzon kërkesën e votuesit?**

Kundër një vendimi të tillë mund të ngrihet padi në Gjykatën Administrative brenda 48 orëve nga marrja

## Aksesi kryhet në ambientet zyrtare të organeve ku ndodhet dokumentacioni zyrtar.

e vendimit. Gjykata Administrative vendos për padinë brenda 24 orëve nga data e marrjes së kërkesëpadisë.

### **Kush ka të drejtë të ketë akses në listën e votuesve?**

Ministria është e detyruar t'i sigurojë partisë parlamentare, parashtruesit të listës së konfirmuar zgjedhore dhe organizatës joqeveritare të autorizuar nga organi kompetent për monitorimin e zgjedhjeve, me kërkesën e tyre, brenda 48 orëve nga dita e pranimit të kërkesës të sigurojë akses elektronik në listën e votuesve, si dhe në ndryshimet e bëra në të.

### **Çfarë do të thotë akses për ndryshimet dhe si aktivizohet qasja?**

Akses në ndryshime nënkupton njohjen e vendimeve në bazë të të cilave ato janë marrë.



Me kërkesën e tyre, Ministria është e detyruar që subjekteve të lartpërmendura t'u mundësojë akses në listën e votuesve dhe të dhënat nëpërmjet lidhjes kompjuterike duke përdorur certifikatë elektronike të avancuar për përdorimin e zgjidhjes softuerike në periudhën nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

**Çfarë nënkuptohet me dokumentacion zyrtar lidhur me ndryshimet në listën e votuesve dhe kush ka të drejtë të ketë akses në të?**

Ministria është e obliguar që me kërkesë të lejojë përfaqësuesin e autorizuar të partisë parlamentare, përfaqësuesin e autorizuar të listës zgjedhore të konfirmuar dhe përfaqësuesin e autorizuar të organizatës joqeveritare të cilës organi kompetent i ka lëshuar autorizimin për të monitoruar zgjedhjet ti sigurojë akses në dokumentacionin zyrtar mbi bazën e të cilit bëhet ndryshimi në listën e votuesve (dokumentacioni: shtetësia, letërnjoftimi i shtetasve, çregjistrimi dhe regjistrimi i vendbanimit, numri i gjendjes civile, regjistri i gjendjes civile të lindjeve dhe vdekjeve).

Ministria është e detyruar t'i sigurojë partisë parlamentare qasje në dokumentacionin zyrtar mbi bazën e të cilit bëhen ndryshime në listën e votuesve dhe në kohën jashtë periudhës së fushatës zgjedhore.

### **Ku bëhet ky akses?**

Akresi kryhet në ambientet zyrtare të autoritetit ku ndodhet dokumentacioni zyrtar.

### **Cilat janë detyrimet e subjekteve që u lejohet akses në listën e votuesve?**

Partia parlamentare, parashtruesi i listës së konfirmuar zgjedhore dhe organizata joqeveritare të cilës organi kompetent i ka lëshuar autorizimin për monitorimin e zgjedhjeve janë të detyruara të caktojnë maksimum tre persona të cilët janë të autorizuar dhe përgjegjës për qasje në sistemin informativ në të cilin mbahet lista zgjedhore dhe për këtë të njoftojë Ministrinë.

### **A ka detyrim MPB-ja të sigurojë akses në listën e votuesve jashtë periudhës së fushatës zgjedhore?**

Ministria është e detyruar t'i mundësojë partisë parlamentare ushtrimin e kësaj të drejte, me kërkesë të saj, edhe gjatë kohës jashtë fushatës zgjedhore.

### **Deri kur MPB-ja është e detyruar të lëshojë dokumentet që janë të nevojshme për ushtrimin e të drejtës së votës?**

Ministria është e detyruar të lëshojë dokumentet publike të nevojshme për ushtrimin e së drejtës së votës jo më vonë se pesë ditë nga data e paraqitjes së kërkesës për lëshimin e tyre.

Afati i referohet kërkesave të paraqitura nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve.



